

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                   |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Maliq Lila, pena që shkruante të vërtetën                                                                                                                         |
| ADRESA  | <a href="https://newsbomb.al/oped/maliq-lila-pena-qe-shkruante-te-verteten-i402049">https://newsbomb.al/oped/maliq-lila-pena-qe-shkruante-te-verteten-i402049</a> |
| BURIMI  | newsbomb.al                                                                                                                                                       |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                            |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 25 shtator 2026, 17:37:19 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 17:33:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 08b89465168496d0208b3b36eab328d20239054e65e5b15cedb8fac3637c5720 |
| TEKSTI     | d5c37285a8710de8f757edd24092e2891caa1c355bb65f187c8f1d695e175657 |
| PAMJA      | 8511f290dd5bbd96bfa8452affae61b5d6a69cf7e2fd62bd3d96ed55f02f5798 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 63ac5ceb7e15c062d59a7d9671ae2c24a629deb068417c5983bd389d387f289f                                |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                               |
| RRËNJA MERKLE | b795f32e8dccad3401c122ecb35fb566e35fee7f00b27116f873c51e2a9a0ff8                                |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/63ac5ceb7e15c062d59a7d9671ae2c24a629deb068417c5983bd389d387f289f>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





12 numrat e parë FALAS!  
Version PDF



Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



## Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

OpEd

25 Shtator 2026, 19:33

# Maliq Lila, pena që shkruante të vërtetën



Shkruar nga Newsbomb



Poeti dhe gazetari Maliq Lila në mjediset e gazetes rajonale "Dita JUG"

## Nga Engjëll Serjani

Sot më erdhi në mendje një nga bashkëpunëtorët e mi më të dashur, një burrë që la gjurmë jo vetëm në jetën time profesionale, por edhe në historinë e gazetës rajonale "Dita JUG": poeti, rapsodi, gazetari dhe burri i shquar i Tepelenës, Maliq Lila.

E kujtoj me respekt, me mall dhe, mbi të gjitha, me krenari. Krenari për faktin se për disa vite patëm fatin të punonim bashkë në një kohë jo të lehtë për gazetarinë shqiptare. Ishin vitet e para pas ndryshimeve politike, kur shtypi i lirë dhe i pavarur përballlej me vështirësi të shumta dhe kur gazetarja bëhej shpesh me më shumë idealizëm sesa me mundësi.

"Dita JUG" ishte një gazetë e tillë. Një gazetë e njerëzve që besonin te fjala e lirë, te e drejta për të treguar atë që ndodhte në komunitet dhe te përgjegjësia që mbart pena e gazetarit.

Në atë redaksi, Maliq Lila ishte më i madhi në moshë mes një grupi gazetarësh të rinj. Por moshë nuk e vendoste atë në një distancë prej tvre. Përkundrazi. Ai ishte niëri prej tvre.

## Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

## Lajmet e fundit



### Politikë

Berisha me premtime para elbasanlinjve: Me fitoren e mandatit të parë, do të dyfishojmë pagat dhe pensionet, do heqim taksat e ushqimeve



### Politikë

Kryeministri Rama në New York: Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës, dëshmi e transformimit të Shqipërisë

Zbulu më shumë artikuj >

kolegu i tyre dhe, pa e kërkuar kurrë një rol të tillë, modeli i tyre.

Si botues dhe drejtor i gazetës, e kam të vështirë të harroj përkushtimin, etikën, seriozitetin dhe korrektësinë e tij në punë. Ai e merrte gazetarinë me një përgjegjësi që sot do të ishte e vështirë të gjendej në atë masë.

Pena e Maliqit ishte e mprehtë në kritikë, por e kthjellët në të vërtetën. Ai nuk kishte nevojë ta zbulonte realitetin për ta bërë interesant. E kërkonte të vërtetën dhe, kur e gjente, e shkruante me guxim.

Kishte edhe një veçanti tjetër që e bënte shkrimin e tij të dallueshëm: dashurinë për gjuhën dhe vargun. Titujt e tij shpesh kishin një ritëm poetik, një rimë që të mbetej në mendje, por që njëkohësisht përcillte një mesazh të qartë. Më kujtohet një prej tyre:

"Vlora, si Vlora. Dhe me këngë ja bën fora."

Ishte Maliqi gazetar me penë të mprehtë, por edhe poet me ndjeshmëri; kritik, por jo cinik; i drejtëpërdrejtë, por gjithmonë korrekt.

Për ne, njerëzit e "Dita JUG", ai ishte më shumë se një bashkëpunëtor. Ishte një pikë referimi. Një njeri tek i cili mund të mbështetesh, një koleg që e respektonte profesionin dhe një zë që nuk e ngatërronte kurrë gazetarinë me interesin personal.

Sot, duke e kujtuar, mendoj se duhet ta themi këtë jo vetëm në emrin tim, por edhe në emër të atyre që punuan me të dhe të gjithë familjes së "Dita JUG".

Faleminderit, Maliqi!

Faleminderit për vitet që na dhurove, për shkrimet, për vargjet, për kritikën, për korrektësinë dhe mbi të gjitha për shembullin që na le.

Gazeta "Dita JUG" mbijetoi dhe u përpoq të ruante identitetin e saj në një periudhë të vështirë të shtypit të lirë në Shqipërinë e Jugut. Në atë rrugëtim pati shumë njerëz që kontribuan. Por mes tyre, emri i Maliq Lilës zë një vend të veçantë.

Sepse disa gazetarë shkruajnë lajme.

Disa të tjerë bëjnë karrierë.

Por ka edhe nga ata që, përmes punës së tyre, i japin gazetarisë një emër, një karakter dhe një ndërgjegje.

Për ne, Maliq Lila ishte një prej tyre.

Një ikonë e vërtetësisë, transparencës dhe guximit gazetaresk.

Dhe kjo është arsyeja pse sot, edhe pas kaq vitesh, "Dita JUG" nuk e harron.

## Sondazh

Poll

## Lexo gjithashtu





🕒 E Martë 19:34

## Luan Rama: Jo vetëm në rastin e Drejtores së Shërbimit Informativ të Shtetit, kur kryeministri është edhe president, dhe presidenti ndihmës i kryeministrit



OpEd

530 milion Euro për Prokurorinë dhe Gjykatën dhe vetëm 28 milion për mbrojtjen, si është ndarë situata financiare në Hagë

🕒 E Martë 11:09



OpEd

Nevoja për kthjelltësi strategjike në kohë zhgënjimi: Lufta jonë është kundër padrejtësisë, jo kundër Perëndimit

🕒 E Shtunë 13:34



OpEd

🕒 E Enjte 16:42

## Thoma Gëllçi: UÇK-ja nuk mbrohet me statuse në "Facebook"



OpEd

Kur agresori shkruan dosjen në Hagë dhe viktimat fle mbi dafina: Nga fitorja e luftës te disfatat e kujtesës

🕒 E Mërkurë 12:41 Adri Nurellari



OpEd

Nota katër në arsim: Pse katër universitetet e reja janë katër dështime të paralajmëruara

🕒 E Hënë 10:03



OpEd



E Diel 16:23 Adri Nurellari

## Ramë Pagëzimori, Rilindishtja dhe arti i qeverisjes me fjalor



OpEd

Një moment vendimtar për Shqipërinë

E Martë 13:45



OpEd

Një dritare mundësie për Tiranën: Pse "Jo"-ja e Islandës ndaj BE-së favorizon integrimin e Shqipërisë

E Diel 18:33



E Martë 14:31 Anila Basha

## Elvis Karaj, ikja e një njeriu që jetoi për të tjerët



OpEd

Kurthi i Kurtit për Republikën: Pse fitorja në zgjedhje nuk të bën pronar të shtetit

E Martë 11:33



OpEd

Ylli Manjani: Dy argumente absurde për kundërshtinë e reformës territoriale

E Diel 13:06



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.